


QENDRA
E PROVIMEVE

**GARAT
SHTETËRORE**
► **UDHËZUES** ● ● ●
**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**



Gara shtetërore nga lënda, **Gjuhë shqipe dhe letërsi** përfaqëson një hap të rëndësishëm në nxitjen dhe përmirësimin e arsimit të nxënësve tanë, duke u mundësuar atyre të thellojnë njohuritë dhe kuptimin e tyre mbi gjuhën dhe letërsinë. Kjo lëndë jo vetëm që zhvillon aftësitë gjuhësore të nxënësve, por gjithashtu kontribuon në nxitjen e mendimit kritik, i cili është thelbësor për të ardhmen e tyre. Gjuha është themeli i komunikimit, i njohjes dhe i kuptimit, dhe zotërimi cilësor i sistemit gjuhësor, funksioneve, rregullave ortografike, ortoepike dhe gramatikore, si dhe përdorimi i tyre, ndikon pozitivisht në aftësinë e shprehjes dhe të kuptimit të ideve dhe koncepteve më të ndërlikuara. Përveç kësaj, gjuha amtare përdoret si gjuhë mësimi në të gjitha lëndët e tjera, ndaj nxënësit përmes njohurive dhe aftësive verbale të fituara në këtë lëndë marrin një bazë që u mundëson atyre përvetësim më të lehtë të mësimin në lëndë të tjera.

Duke qenë se letërsia është izomorfe me kulturën, në komunikim me tekstet letrare, nxënësve u zbulohen modele të ndryshme kulturore, që u mundësojnë atyre njohjen e kulturave dhe traditave më të rëndësishme botërore. Megjithatë, mësimi i gjuhës dhe letërsisë ka një rëndësi vendimtare edhe për formimin e modeleve të identitetit, gjë që e ngarkon këtë garë me një kuptim shtesë semiotik. Duke zotëruar përdorimin më të hollë të gjuhës, i cili arrihet pikërisht në tekstet letrare, duke ndjekur proceset semiotike dhe kulturore përmes letërsisë, si dhe duke përvetësuar kodet kulturore dhe strategjitë komunikuese, nxënësit aftësohen të interpretojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike tekste të ndryshme, duke zhvilluar kështu aftësinë për mendim të pavarur dhe argumentim. Përmes mësimin të kësaj lënde, ata kuptojnë rëndësinë e mirëkuptimit, respektimit, punës në grup, bashkëpunimit, tolerancës, respektimit të dallimeve, dhe veçanërisht kulturës së dialogut. Fiktiviteti dhe funksionet e veçanta të së vërtetës artistike, e cila shprehet në tekstin letrar, marrin pjesë në masë të madhe në formimin e sistemit të vlerës të nxënësve dhe zhvillojnë ndjenjën e tyre për drejtësi.

Mësimi i gjuhës shqipe dhe letërsisë i nxit nxënësit të hulumtojnë, të bëjnë pyetje dhe të zhvillojnë potencialet e tyre, duke kontribuar kështu në krijimin e individëve të arsimuar dhe kritikë, të gatshëm për t'u përballur me sfidat e shoqërisë moderne, pasi aftësia për të lexuar dhe kuptuar, si dhe njohja e rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore, janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin personal dhe profesional të individit. Në këtë drejtim, gara shtetërore nga kjo lëndë përfaqëson mbështetje, dhe veçanërisht promovim të nxënësve më të talentuar, të cilët janë potenciali dhe fuqia e zhvillimit të ardhshëm të shoqërisë sonë. Pikërisht për shkak të përfitimit të paçmuar që kanë nxënësit nga kjo lëndë, është e domosdoshme të organizohet gara dhe të vlerësohen më të mirët, ata që janë të përkushtuar ndaj gjuhës dhe letërsisë dhe që synojnë të mësojnë më shumë sesa është paraparë nga programi.

KATEGORITË E GARËS

1. Shkolla fillore

- ▶ klasa e gjashtë
- ▶ klasa e nëntë

2. Shkolla e mesme

- ▶ klasa e parë dhe e dytë
- ▶ klasa e tretë dhe e katërt

FUSHAT E GARËS NË TË GJITHA KATEGORITË

1. Gjuha

Me detyrat nga fusha e **gjuhës** verifikohet:

- ▶ njohuria e nxënësve për gjuhën, strukturën gjuhësore; funksionet e gjuhës, vetitë e gjuhës, origjina e gjuhës dhe e shkrimit, familjet gjuhësore, shenja gjuhësore;
- ▶ njohja e historisë së gjuhës, reformave dhe zhvillimit të gjuhës standarde;
- ▶ dialektologjia; dialektet dhe të folmet;
- ▶ kuptimi i procesit të standardizimit dhe kodifikimit;
- ▶ njohja e normës drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore;
- ▶ fonetika, klasifikimi i tingujve dhe tiparet e tyre artikuluese dhe akustike;
- ▶ fonologjia, fonema, ndryshimet fonetike, apofonia, metafoia, qiellzorizimi, rotacizmi
- ▶ prozodia: thekset dhe gjatësia e zanoreve;
- ▶ morfologjia, morfema, llojet e morfemave, llojet e fjalëve, kategoritë gramatikore;
- ▶ fjalëformimi: struktura e fjalës, përbërësit e fjalës, fjalë të parme dhe jo të parme
- ▶ leksikologjia, leksema, ndarja e leksikut, kategoritë leksiko-semantike;
- ▶ frazeologjia, përkufizimet, tiparet dhe klasifikimet e frazeologjizmave;
- ▶ sintaksa e sintagmës;
- ▶ sintaksa e fjalisë;
- ▶ funksioni i rasave;
- ▶ sintaksa e foljes (kallëzuesi);
- ▶ sintaksa e tekstit ose analiza e diskursit;
- ▶ shtresëzimi i gjuhës: territorial, shoqëror, individual dhe funksional;
- ▶ pragmatika, përdorimi i gjuhës, aktet e të folurit.

2. Letersia

Përmes detyrave nga fusha e **shkencës mbi letërsinë** verifikohet:

- ▶ njohuria e nxënësve mbi teorinë e letërsisë, historinë e letërsisë dhe metodat mbi studimin e letërsisë;
- ▶ kuptimi i natyrës së letërsisë dhe fenomenit të fiktivitetit;
- ▶ njohja e funksionit estetik të gjuhës;
- ▶ vërejtja e veçorive të gjuhës poetike, ambivalenca dhe autorefleksiviteti i saj;
- ▶ aftësia për të zbatuar konceptet e përvetësuara teoriko-letrare në interpretimin e teksteve letrare të larmishme nga aspekti gjenealogjik;
- ▶ dallimi midis diskursit lirik, narrativ dhe dramatik;
- ▶ njohja e tipareve poetike të tekstit letrar dhe kategorizimi i tij në një formacion stilistik adekuat;
- ▶ zotërimi i sistemit të figuracionit stilistik;

- ▶ aftësia për të identifikuar elemente të strukturës narrative, si: rrëfimtari, situata rrëfimtare, këndvështrimet (ideologjike, frazeologjike, hapësinore-kohore dhe psikologjike), format e rrëfimit, personazhet, fabula dhe subjekti, kronotopi (koha dhe hapësira), organizimi temporal, organizimi hapësinor, mekanizmat motivues, teknikat e modelimit introspektiv të personazheve, sekuencat kompozicionale, motivet dinamike dhe statike, lajtmotivet, mjetet e retardimit, digresionet, përshkrimi, komentet (refleksionet), dominimi i shenjës ikonike etj.;
- ▶ vërejtja e elementeve dhe tipareve të strukturës lirike dhe njohja e fenomenit të vargut, sjellja e sintaksës në një varg të ndarë, paradigmave ritmike-metrike, përsëritjeve të elementeve shprehëse, kufijve konstruktivë të vargut, faktorëve prozodikë, vargut të lirë, vargut popullor, rimës, strofës, subjektit lirik, parimit asociativ të motivimit, stilogjenezës së mjeteve gjuhësore, boshtit të seleksionimit të njësive verbale, boshtit të kombinatorikës së njësive verbale, dominimit të motiveve statike, prania e theksuar e shenjave ekspresive (emocionale, indeksore), format e qëndrueshme poetike, format klasike etj.;
- ▶ kuptimi i parimeve organizative të diskursit dramatik dhe njohja e formave të të folurit në dramë, funksionit të motiveve dinamike në zhvillimin e veprimit dramatik, tre uniteteve dramatike, fazave të zhvillimit të veprimit dramatik, funksioneve gjuhësore në dialog, vërejtjes së konfliktit, personazheve (fytyrat, karakteret, dramatis personae) dhe funksioneve të tyre dramatike (protagonist/antagonist), mënyrave të karakterizimit të personazheve, deikticitetit dhe performativitetit të diskursit dramatik, formave historikisht të kushtëzuara të dramës, teknikave bazë dramatike, funksionimit të akteve të të folurit në dramë, sekuencave kompozicionale, gjuhës skenike, parimeve konstruktive të antidramës etj.;
- ▶ njohja e metodave të qasjes së brendshme dhe të jashtme ndaj tekstit letrar.

Nxënësit në test duhet të tregojnë njohuri që në një masë të caktuar tejkalojnë përmbajtjet e përfshira në programin mësimor, pra ata duhet të kuptojnë informacionet e shkruara dhe të zbatojnë ligjshmëritë gjuhësore duke përdorur njohuritë dhe përvojat e mëparshme, si edhe një spektër të gjerë udhëzimesh tekstuale dhe situatave që shpesh janë të kushtëzuara nga aspekti shoqëror dhe kulturor.

Nxënësit do të kenë për analizë ekskluzivisht tekste letrare: narrative, lirike dhe dramatike, si ato që janë të përcaktuara nga kanonet, ashtu edhe ato që ofrohen si plotësim i programeve shkollore.

Zgjedhja e teksteve bëhet në varësi të moshës së nxënësve dhe nivelit të të nxënësve, ndërsa llojet e detyrave dhe metodat e testimit janë të njëjta në të gjitha kategoritë e garës.

RREGULLAT:

- ▶ garuesi/garuesja shkruan me shkronja shtypit ose dore (nëse shkruan me shkronja shtypit, duhet të theksojë shkronjën e madhe);
- ▶ përgjigjet duhet të jenë të shkruara saktë nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore;
- ▶ përgjigjet duhet të shkruhen me stilolaps me bojë të zezë ose blu në hapësirën e parashikuar për këtë (ndalohet përdorimi i lapsit "shkruaj-fshij" pasi boja nuk duhet të fshihet);
- ▶ nëse garuesi/garuesja gabon, mund ta shënojë gabimin duke e vizuar dhe të shkruajë përgjigjen e re me të njëjtin stilolaps;
- ▶ nuk lejohet përdorimi i korrektorit.

Mjetet e lejuara për punë: lapsi grafit, goma, stilolapsi me ngjyrë blu ose të zezë.

Lapsi grafit mund të përdoret gjatë punës, por përgjigjja përfundimtare duhet të shkruhet me stilolaps.

Nuk lejohet përdorimi i: telefonit celular dhe asnjë mjeti tjetër elektronik ndihmës.

E RËNDËSISHME: Procedurat dhe rregullat më të detajuara të garës janë përshkruar në UDHËZUESIN PROFESIONAL PËR GARËN SHTETËRORE TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME

KOHËZGJATJA E TESTIT	Klasa e gjashtë: 90 minuta Klasa e nëntë: 90 minuta Klasa e parë dhe e dytë e shkollës së mesme: 120 minuta Klasa e tretë dhe e katërt e shkollës së mesme: 120 minuta	
Fushat	Gjuha: <ul style="list-style-type: none"> ▪ fonetika ▪ fonologjia ▪ ortografia ▪ prozodia ▪ morfologjia ▪ fjalëformimi ▪ leksikologjia ▪ sintaksa ▪ semantika 	Letërsia: <ul style="list-style-type: none"> ▪ teoria e letërsisë ▪ historia e letërsisë ▪ analiza e tekstit letrar
Numri i teksteve sipas kategorive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Klasa e gjashtë: 2 tekste (1 tekst lirik, 1 tekst narrativ) ▪ Klasa e nëntë: 3 tekste (1 tekst lirik, 1 tekst dramatik, 1 tekst narrativ) ▪ Klasa e dytë e shkollës së mesme: 5 tekste (2 tekste lirike, 1 dramatik, 2 narrative) ▪ Klasa e katërt e shkollës së mesme: 7 tekste (2 tekste lirike, 2 dramatike, 3 narrative) 	
Pjesëmarrja në test	Gjuha:	Letërsia:
	50 pikë	50 pikë
Llojet e detyrave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ zgjedhje e shumëfishtë ▪ zgjedhje alternative ▪ përgjigje e shkurtër ▪ detyra të lidhjes ▪ detyra të renditjes ▪ detyra të plotësimit ▪ transformimi i fjalisë (gjuha) 	

Udhëzuesin e përgatitën:

Dr. Tatjana Gjurishiq Beçanoviq, Fakulteti Filologjik, Nikshiq


Dr. Rajka Gllushica, Fakulteti Filologjik, Nikshiq

Dragana Nenadoviq, Qendra e Provimeve, Podgoricë

Valbona Hoxhiq, SHF "M. Tito", Ulqin

Mr. Marjan Lulgjuraj, SHMP "25 Maji", Tuz

Luigj Berisha, Qendra e Provimeve, Podgoricë



▶▶▶ www.iccg.co.me

